



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TATIMORE
DREJTORIA E TATIMEVE DIREKTE
SEKTORI I TAKSIMIT NDËRKOMBËTAR

Nr. 8959/2 prot.

Tiranë, më 23. 6.2026

Lënda: Kthim përgjigje.

SHOQATËS KOMBËTARE TË TRANSPORTIT QYTETAS ✓
Rruga "Llazi Miho", Nd. 6, Shk. 1, Kat. 1, Kombinat, Tiranë

Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE
Rruga "Gjin Bue Shpata", Tiranë

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë

Në adresë të Ministrisë së Financave ka mbërritur shkresa juaj e datës 22.5.2026, protokolluar me tonën me Nr. 8959 Prot., datë 25.5.2026, nëpërmjet së cilës kërkoni sqarim mbi zbatimin e detyrimit për pajisjen me терминаlet "POS/POI", në transportin publik qytetas.

Në vijim të shqyrtimit të përmbajtjes së shkresës suaj, dëshirojmë t'ju sqarojmë se:

Në paragrafin 1, të nenit 59/3, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, janë parashikuar tatimpaguesit që kryejnë shitje me para në dorë, që duhet të jenë të pajisur me terminal "POS/POI" në çdo pikë shitjeje, sipas kalendarit të përcaktuar.

Por, në shkronjën "b", të paragrafit 2, të këtij neni, është përcaktuar se:

"2. Përfshihen nga detyrimi i pajisjes me terminal "POS/POI":

...
b) tatimpaguesit që përfshihen nga detyrimi për të lëshuar faturë, sipas ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit;"

Ndërkohë, në shkronjën "b", të paragrafit 1, të nenit 5, të ligjit nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", të ndryshuar, është parashikuar se:

“1. Përjashtimisht përcaktimeve në nenin 4, të këtij ligji, tatimpaguesi nuk është i detyruar të lëshojë faturë për llojet e veprimtarive dhe për furnizimin e mallrave e të shërbimeve si më poshtë:

...
b) për shitjen e biletave ose kuponave nga shoferi i një mjete transporti pasagjerësh në linjat e transportit publik urban, në përputhje me vendimet e njësive të vetëqeverisjes vendore;”.

Përsa më sipër, nga leximi i kombinuar i këtyre dispozitave ligjore, rezulton se operatorët e transportit publik urban brenda qytetit (autobusët), duke qenë të përjashtuar nga detyrimi për të lëshuar dhe fiskalizuar fatura për furnizimet që kryejnë, nëse bileta ose aboneja u jepet pasagjerëve direkt nga drejtuesi i mjetit ose nga një person i autorizuar, rrjedhimisht janë të përjashtuar edhe nga detyrimi ligjor për t’u pajisur me terminal “POS/POI” në çdo pikë shitjeje, në rastin konkret në çdo autobus urban individual, që operon brenda qytetit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Gentian Këri

